



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2021

KTHIM PËRGJIGJE

Zj _____

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, të ligjit nr 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, shkresës tuaj adminisdtruar nga Bashkia Shkodër me nr 16051 prot datë 23.9.2021 “Kërkesë”, Ju informojmë që:

Bashkia Shkodër administron 82 objekte shkollore të shpërndara në një territor prej 873 km katror, sipas ndarjes: shkolla në qytet 26, dhe 56 shkolla në Njësi Administrative.

1. Shkollat që janë me emergjente për sa i përket infastrukturës janë si më poshtë:
Shkolla “Azem Hajdari”, Lagjia nr 2 Qytet me rreth 299 nxënës
Shkolla “Salo Hili”, Lagjia nr 1 Qytet me rreth 297 nxënës
Shkolla “Skenderbej”, Lagjia nr 2 Qytet me rreth 474 nxënës
Shkolla “Kir” Njësia Administrative Pult, me rreth 13 nxënës
Shkolla “Drisht” Njësia Administrative Postribë me rreth 61 nxënës
Shkolla “Ismet Sali Bruçaj”, Njësia Admnistriave Rrethina me rreth 98 nxënës
Shkolla “Mehemet Shpendi” Njësia Administrative Shalë me rreth 82 nxënës
2. Me Vendim të Këshilit Bashkiak nr 63 datë 28.12.2020, i ndryshuar janë miratuar projektet për investimet në shkolla për vitin 2021 në shumën 37 076 361 lekë që mbulon 6.6% projekteve të infrastruktures në shkolla që kemi të gatshme për financim në vlerën rreth 556 651 823 lekë.
3. Bashkia Shkodër, ka aplikuar në çdo thirrje të hapur nga Ministria me projektet për investimet në shkolla si poshtë vijon:
 - Në zbatim të Vendimit nr 27 datë 20.05.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për “shpalljen e thirrjes së dytë, për vitin 2016, për financimin e projekteve, nga grand i

arsimit, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla i, e fondit për zhvillimin e rajoneve, Bashkia Shkodër aplikon me projektin:

1. **Rikonstruksion Shkolla 9 vjeçare “Azem Hajdari”, Lagjia nr 2 Qytet**
2. **Rikonstruksion Shkolla 9 vjeçare “Ismail Qemali”, Lagjia nr 1 Qytet**
3. **Rikonstruksion Shkolla “Jordan Misja”, Lagjia nr 3 Qytet**
4. **Rikonstruksion Shkolla 9 vjeçare “Mati Logoreci”, Lagjia nr 3 Qytet**

➤ Në zbatim të Vendimit nr 15 datë 21.03.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për ”Për shpërndarjen e financimit, për projekte të reja ,Thirrja I për vitin 2017, Granti “Arsimit”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, Shtylla 1 e fondit të Zhvillimit të Rajoneve, Bashkia Shkodër aplikon me projektin:

1. **Rikonstruksion Shkolla 9 vjeçare “Azem Hajdari”, Lagjia nr 2 Qytet**
2. **Rikonstruksion Shkolla “Kir”, Njësia Administrative Pult**
3. **Rikonstruksion i pjesshëm shkolla “Ura e Shtrenjt”, Njësia Administrative Postribë**

➤ Në zbatim të vendim nr. 6, datë 10.04.2018 të KZHR, për shpalljen e thirrjes së parë, për financimin e projekteve nga grantet “arsimi”, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve, për vitin 2018 , të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “për buxhetin e vitit 2018”, të ligjit 139/2015 “për vetqeverisjen vendore”, Bashkia Shkodër aplikon me projektin:

1. Jeto me Sportin

➤ Në zbatim të vendim nr. 11, datë 27.09.2018 të KZHR, për shpalljen e thirrjes së dytë, për financimin e projekteve nga grantet “arsimi”, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve, për vitin 2018 , aneksi 3, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “për buxhetin e vitit 2018”, të ligjit 139/2015 “për vetqeverisjen vendore”, në kuadër të thirrjes së dytë, për financimin e projekteve nga Grantet për “Arsimin”-grantit “Arsimi bazë” pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve viti 2018 dhe “Programit të Integruar për zhvillimin rural - Programi 100 Fshatrave”, miratuar me VKM nr 21 datë 12.08.2018, Bashkia Shkodër aplikon me projektin:

1. “Rikonstruksion Shkolla 9- vjeçare Drisht”, Njësia Administrative Postribë.

➤ Në zbatim të vendim nr. 1, datë 28.02.2019 të KZHR, për shpalljen e thirrjes së parë, për financimin e projekteve nga grantet “arsimi bazë”,arsimi i mesëm pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve, për vitin 2019 , pika 2) c, reabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të objekteve arsimore në arsimin parauniversitar (arsimi bazë dhe i mesëm, përfshirë shkollat e mesme të bashkuara), përmirësimin e infrastrukturës shkollore (arsimi bazë dhe i mesëm, përfshirë shkollat e mesme të bashkuara), në zonat dhe fshatrat pjesë e “ Programit të Integruar për zhvillimin rural - Programi 100 Fshatrave”, miratuar me VKM nr 21 datë 12.08.2018, Aneksi 3, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ligjit

139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, në kuadër të thirrjes së pare, për financimin e projekteve nga Grantet për “Arsimi Bazë”, “Arsimi i Mesëm” pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve viti 2019, Bashkia Shkodër aplikon me projektet:

1. **Jeto me Sportin-Faza II (Rikualifikimi i terreneve sportive shkolla 9- vjeçare “Ndre Mjeda” dhe shkolla e mesme “Prek Jakova”), Lagjia nr 1 dhe lagjia nr 3 qytet**
2. **“Rikonstruksion shkolla 9- vjeçare “Drisht”, Njësia Administrative Postribë.**

Nga aplikimet e mësipërme janë miratuar dhe bashkëfinancuar me MAS projektet si më poshtë:

1. **Jeto me sportin me vlerë 31 571 471 lekë**
2. **Rikonstruksion i pjesshëm shkolla “Ura e Shtrenjt”, Njësia Administrative Postribë, me vlerë 7 105 224 lekë**

Projektet e tjera nuk janë financuar nga programet e MAS, megjithatë Bashkia Shkodër, në vitin 2021 me fondet nga të ardhurat e veta ka financuar një pjesë të këtyre projekteve siç janë:

1. **Rikonstruksion Shkolla “Jordan Misja”, Lagjia nr 3 Qytet**
2. **Rikonstruksion Shkolla 9 vjeçare “Ismail Qemali”, -Ngrohja me kladajë**
3. **Rikonstruksion Shkolla 9 vjeçare “Azem Hajdari”, në proces për realizimin e procedurës prokurimit faza e parë.**

Informacion më të detajuar për çdo vit nga viti 2016-2021 e gjeni në modulën Transparenca e Buxhetit, në Programet: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor, Arsimi mesëm i përgjithshëm, Arsimi mesëm profesional, në linkun <https://buxheti.info/shkoder/>

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETAR

Voltana ADEMI

